



VENDIM

Nr. 127 Datë 02.12.2011

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “BALLKAN GREEN ENERGY” SH.P.K
NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g”, 5 pika 1, 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.12.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ballkan Green Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

Konstatoi se :

- Aplikimi i shoqërisë “Ballkan Green Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të licensave.
- Në datën 01.11.2011 me shkresën nr. 417/1 Prot., rezultoi e paraqitur një ankesë jashtë afatit 2 – mujor të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore të ERE-s, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Ballkan Green Energy” sh.p.k, për licensim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Ankesa e sipërcituar është jashtë objektit të këtij licensimi dhe nuk prek aspak vendimmarrjen e ERE-s mbi licensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë të shoqërisë “Ballkan Green Energy”.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “Ballkan Green Energy” sh.p.k në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.